



UNOSEK/PR/7
E martë, 23 maj 2006

Delegacionet e Prishtinës dhe Beogradit diskutojnë mbrojtjen e trashëgimisë religjioze dhe kulturore në Kosovë

Vienë – Sot në Vienë delegacioni i Prishtinës dhe i Beogradit mbajtën raundin e negociatave të drejtpërdrejta mbi mbrojtjen e trashëgimisë religjioze dhe kulturore në Kosovë. Bisedimet u zhvilluan nën patronatin e të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, Martti Ahtisaarin dhe u kryesuan nga zëvendësi i tij, Albert Rohan.

Pastaj, në një konferencë për shtyp z. Rohan tha: “Edhe pse ka një sërë dallimesh konceptuale, nëse shikoni masat individuale për mbrojtjen e kishës dhe vendeve religjioze, janë arritur marrëveshje të shumta, që paraqet një bazë të mirë për vazhdimin e cilësdo pune lidhur me këtë temë”.

Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm njoftoi se palët ishin pajtuar që të krijojnë një grup të ekspertëve, i përbërë nga palët e përfshira dhe institucionet ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë, siç janë UNESCO dhe Këshilli i Evropës, që së bashku të diskutojnë rreth kriterëve për krijimin e zonave mbrojtëse rreth vendeve religjioze, dhe caktimin e kufijve të këtyre zonave për secilin rast veç e veç.

Z. Rohan tha se është arritur “një marrëveshje e përgjithshme” që qasja për pelegrin, për autoritetet dhe të tjerët në kisha dhe manastire, parimisht, të jetë në diskrecion të institucionit përkatës të përfshirë, duke shtuar se janë arritur marrëveshje të gjëra mbi përparësitë në taksat dhe detyrimet doganore, dhe se Kishës Ortodokse serbe t’i ofrohet çfarëdo mbështetje lidhur me mirëqenien, përfitimet sociale dhe pensionale apo sigurimin shëndetësor, që sigurohen nga cilido që dëshiron t’i ofrojë ato, duke përfshirë edhe Beogradin.

Z. Rohan njoftoi se palët “parimisht janë pajtuar për krijimin e një kimisioni implementues për të mbikëqyrur implementimin e të gjitha marrëveshjeve për mbrojtjen e vendeve religjioze që do të përfshihen në marrëveshjen mbi statusin”. Ai shtoi se UNOSEK aktualisht është duke pritur propozimet e të dyja palëve lidhur me kushtet e punës dhe përbërjen e komisionit.

Raundi tjetër i bisedimeve të drejtpërdrejta, që do të përqëndrohen në ekonominë, do të mbahen në Vienë, më 31 maj 2006.